

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it zhvilloi një takim me studentët Alumni të Njesisë Bazë të Infermierisë. Tema e takimit ishte: "Eksperienca e punësimit pas përfundimit të studimeve dhe sfidat e profesionit".

Sot të diplomuarit e UGJ në degën e Infermierisë janë të punësuar në institucione publike dhe private, brenda dhe jashtë qarkut, duke kontribuar për komunitetin dhe duke përfaqësuar rolin e infermierit në formën më dinjitoze.

Në këtë takim u diskutua edhe mbi mundësitë e bashkëpunimit me të gjithë brezat e të diplomuarve, historitë e suksesit, ide për aktivitete dhe projekte të përbashkëta, si dhe ruajtje rrjetit Alumni.

